



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Departamenti i Zhvillimit Regjional dhe Integriteteve Evropiane

**Raport përmbledhës i projekteve të realizuara nga MAPL në
bashkëpunim me komuna gjatë vitit 2010**

Dhjetor 2010

Përmbajtja:

FJALA HYRËSE E MINISTRIT

Të nderuar lexues,

Periudha pas nesh, tregon një tendencë në rritje pothuajse në të gjitha parametrat e procesit të decentralizimit. Megjithatë, Kosova ende ka nevojë që të rris kapacitetet e saja në infrastrukturën publike. Në planin afatgjatë, procesi i reformës së pushtetit lokal garanton këtë. Natyrisht, ky është një proces i gjatë dhe kompleks, dhe në këtë drejtim, ka nevojë për përkrahje që ti rris kapacitetet institucionale dhe teknike për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve për të gjithë qytetaret.

Qeveria e Kosovës dhe donatorët kanë siguruar një kontribut thelbësor për këtë proces dhe janë plotësisht të përkushtuar që këtë mbështetje ta vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme.

Raporti që keni në dorë, paraqet investimet publike komunale që ka bërë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2010.

Ne shpresojmë që këto investime, do të shtojnë kapacitetet komunale, përmes të cilave individët, organizatat dhe gjithë shoqëria përgjatë periudhës së ardhshme kohore mund të kenë, forcojnë dhe mirëmbajnë aftësitë e tyre për të përcaktuar dhe arritur objektivat e tyre zhvillimore, sepse qytetaret tanë kanë nevojë për shërbime më efikase.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përkrah të gjitha komunat, duke përfshirë edhe komunat e reja, me mjete buxhetore për të realizuar projekte të ndryshme të infrastrukturës publike dhe po ashtu Ministria është koordinatori kryesor për nivelin lokal për të orientuar ndihmën e jashtme në mënyrën e duhur dhe sipas prioriteteve.

Nga ky raport ju mund të vëreni se, duke punuar bashkë me komunat ne kemi shtuar sipërfaqet e parkingjeve dhe gjelbërimeve, kemi godina shkollore e shëndetësore të reja, kemi shtuar kilometrat e qypave të ujit e rrjetit të kanalizimeve, kemi ndërtuar godina për stafin e administratës komunale dhe tani bilanci është shumë më mirë se vetëm një vit më parë.

Prandaj, shpresojmë që duke vazhduar për të punuar bashkërisht, do të rrisim këto kapacitete, për të krijuar një ambient të sigurt dhe të prosperuar për qytetarët e Kosovës.

Sinqerisht,



Slobodan Petrović, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

1. Përmbledhja ekzekutive	2
2. Koordinimi dhe Monitorimi i Projekteve	3
3. Raporti detaj për secilin prej 99 projekteve sipas regjioneve koordinuese	4
Fushë Kosovë	
Ndërtimi i fushave për sporte të vogla.....	4
Fushë Kosovë	
Ndërtimi i fushave të vogla sportive	5
Fushë Kosovë	
Ndërtimi i terenit sportiv ne oborrin e shkollës fillore “Mihail Grameno”	6
Suharekë	
Ndërtimi i rrugës "Brigada 123" Faza II	7
Malishevë	
Kanalizimi ne fshatin Temeqin-Bubel	8
Deçan	
Ndërtimi i rrugës Sali Qeku dhe Sheshi Mentor Tolaj	9
Deçan	
Platoja hyrëse para objektit te komunës.....	10
Deçan	
Ndriçimi i rrugës “Sali Qeku”	11
Gjakovë	
Ndërtimi i shkollës fillore "Isa Boletini" Osek Hylë në Gjakovë.....	12
Istog	
Ndërtimi i kanalizimit fekale në Banje- Lagja e Gecajve.....	13
Istog	
Asfaltimi i rrugës në fshatin Kërrnin (faza e II)	14
Istog	
Asfaltimi i rrugës ne Istog të Poshtëm	15
Pejë	
Nivelizimi i qendrës së qytetit në Pejë	16
Junik	
Ndërtimi i Objektit të Administratës K.K.Junik.....	17
Junik	
Rregullimi i oborrit të ndërtesës së komunës.....	18
Glllogoc	
Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik	19
Lipjan	
Ndërtimi i Kanalizimit Fekal në Fshatin Shalë-Faza e II.....	20
Obiliq	
Ndërtimi i rrugës Lajthisht - Hamidi.....	21
Obiliq	
Kanalizimi në fshatin Dardhishtë-Obiliq	22
Obiliq	

Asfaltimi i rrugës në fshatin Plemetin-Lagja e Bregajve	23
Podujevë	
Asfaltimi i rrugës Letancë – Bajqinë	24
Podujevë	
Rregullimi i lumit Llap	25
Podujevë	
Asfaltimi i rrugës “Dëshmorët” me kanalizim fekal	26
Prishtinë	
Renovimi i sallës së Kuvendit.....	27
Graçanicë	
Rregullimi i shtratit të lumit Graçanicë.....	28
Graçanicë	
Ndërtimi i fushës së tenisit në Graçanicë.....	29
Graçanicë	
Rregullimi dhe ndriçimi i trotuareve Dobrotnë-Gustericë.....	30
Graçanicë	
Rregullimi i ndriçimit prej Graçanicës deri në Llapnasellë	31
Graçanicë	
Rregullimi i fushës së futbollit në Dobratin.....	32
Graçanicë	
Asfaltimi i rrugës Graçanicë-Llapnasellë.....	33
Graçanicë	
Kolektori i shiut ne Graçanicë	34
Graçanicë	
Rregullimi i terenit sportiv te shkolla e Kishnicës	35
Graçanicë	
Rregullimi i terenit sportiv te çerdhja e fëmijëve në Graçanicë	36
Graçanicë	
Sanimi dhe rekonstruimi i ndriçimit në fshatrat e Gracanicës.....	37
Graçanicë	
Rekonstruimi i udhëkryqit te ura në Llapnasellë	38
Graçanicë	
Rekonstruimi i udhëkryqit në Preoc.....	39
Graçanicë	
Rrethoja rreth kishës në Gushtericën e Epërme	40
Graçanicë	
Përfundimi i ndërtesës së ambulancës në Gushtericë të Epërme	41
Graçanicë	
Qendra tregtare në Graçanicë.....	42
Graçanicë	
Rregullimi i rrugës kryesore në Graçanicë (projekti në vazhdim)	43
Prizren	
Ndërtimi i zyrës së vendit në fshatin Zhur.....	44
Prizren	
Ndërtimi i Rrugës Janina.....	45

Rahovec	
Kanalizimi ne lagjen Strana	46
Mamusha	
Rregullimi i urës në lumin Toplluha	47
Shtërpce	
Ndërtimi i ballon sallës.....	48
Shtërpce	
Asfaltimi i rrugës ne lagjen Coklare	49
Novo Bërda	
Riparimi i shkollës fillore në Stanishor	50
Novo Bërda	
Asfaltimi i rrugës Qylkovc.....	51
Novo Bërda	
Asfaltimi i rrugës Hamdijaj.....	52
Novo Bërda	
Riparimi i rrugës Parallovo.....	53
Novo Bërda	
Riparimi i rrugës Busince -Jasenoc (faza e I)	54
Kaçanik	
Punimi i shkollës 4 klasëshe në fshatin Vatë-Dubravë.....	55
Kamenicë	
Asfaltimi i rrugës qarkore në Kamenicë.....	56
Kamenicë	
Staza, ura metalike,ndërtimi i rrugës në lagjen malësia	57
Ferizaj	
Renovimi i Objektit të ish TMK-së dhe Revitalizimi i tij në objekt të Kulturës	58
Hani Elezit	
Kanalizimi Fekal për fshatin Paldenicë	59
Hani Elezit	
Furnizimi dhe implementimi i infrastrukturës të rrjetit kompjuterik.....	60
Partesh	
Rregullimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në fshatin Budrikë-Gjilanë/Partesh	61
Ranillug	
Furnizim me pajisje sportive.....	62
Ranillug	
Projekti i pastrimit të deponimeve të egra në Komune.....	63
Ranillug	
Organizimi i aktiviteteve kulturore sportive në komunën e Ranillugut	64
Ranillug	
Adaptimi i sallës së kulturës në Domoroc	65
Ranillug	
Ndriçimi publik në Crepane.....	66
Ranillug	
Hartimi i projektit për ndërtimin e banesave KK-Ranillug.....	67
Klinë	
“Kanalizimi fekale ne fshatin Gllarev” Klinë	68

Klinë	
Furnizimi me inventar te punës për objektin e ri komunal.....	69
Dragash	
Ndërtimi i rrugës lokale në fshatin Zym.....	70
Mitrovicë	
Renovimi i objektit të Administratës Komunale të Mitrovicës.....	71
Mitrovica	
Ujësjiellësi ne fshatin Kodër” në Mitrovicë.....	72
Mitrovica	
Renovimi I qendrës se kulturës Rexhep Mitrovica.....	73
Mitrovica	
Platoja para komunës.....	74
Mitrovica	
Parkingu pas objektit te komunës.....	75
Mitrovica	
Ndërtimi i rrugës në Vernicë – Mitrovicë	76
Skenderaj	
Ndërtimi i objektit të Kuvendit Komunal.....	77
Vushtrri	
Ndërtimi i rrjetit të ujësjiellësit në dhjetë fshatrat e Vushtrrisë	78
Vushtrri	
Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Magjunaj.....	79
Vushtrri	
Renovimi i objektit të ish TMK-së.....	80
Vushtrri	
Shtruarja me kubëza të betonit te segmentit rrugore “Jeton Terstena”	81
Vushtrri	
Shtruarja me kubëza të betonit të dy segmenteve rrugore "Avni Kutlllovci"	82
Vushtrri	
Ndërtimi i vend ndaljeve për autobusë së bashku me kabinat si dhe sinjalizimi i disa rrugëve.....	83
Gjilan	
Asfaltimi i rrugës në fshatin Shillove	84
Gjilan	
Ndërtimi i sallës së edukatës fizike,çerdhës për fëmije parashkollor dhe ndërtimi I mbulesës së objektit të shkollës fillore "Abdulla Tahiri"	85
Gjilan	
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Makresh të Epërm.....	86
Gjilan	
Përfundimi i objektit të shtëpisë e kulturës në Stanishor	87
Gjilan	
Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në Partesh	88
Klllokot	
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Klllokot.....	89
MAPL	
Blerja e 6 veturave për nevoja të Komunave të reja.....	90
MAPL	

Furnizim me pajisje të TI(per komuna te reja)	91
MAPL	
Blerja e 3 veturave për nevoja të Komunave të reja.....	92
Ranillug.....	93
Punimi i Informatorit Vjetor te Komunës - Ranillug.....	93
Ranillug.....	94
Organizimi i turnirit ne futbollin e vogël për klubin Futbollistik “ Slloga “ në Ranillug	94
Novo Bërd	
“ On Air” në Komunën e Novo Bërdës	95
NovoBërdë	
“Përkrahja e Iniciativave multietnike ne komunën e Novo Bërdës”	96
NovoBërdë	
Furnizimi i farës se grurit për fermerët e Komunës së Novo Bedrës	97
Kllokot	
Punimi i Informatorit Vjetor të Komunës	98
Mitrovica	
“Konferenca Përruese e Forumit të qytetit ne Tranzicion”	99
Mitrovica-Leposaviq-Zveçan dhe Zubin Potok	
Thirrja për propozim për grante të vogla për OJQ-të.....	100
Mitrovicë	
Furnizimi me dru për kategoritë e rrezikuara në pjesën urbane të qytetit-Mitrovicë	101
Lista me Projektet e komunave të financuara nga MAPL per vitin 2010	102

FJALA HYRËSE E MINISTRIT

Të nderuar lexues,

Periudha pas nesh, tregon një tendencë në rritje pothuajse në të gjitha parametrat e procesit të decentralizimit. Megjithatë, Kosova ende ka nevojë që të rris kapacitetet e saja në infrastrukturën publike. Në planin afatgjatë, procesi i reformës së pushtetit lokal garanton këtë. Natyrisht, ky është një proces i gjatë dhe kompleks, dhe në këtë drejtim, ka nevojë për përkrahje që ti rris kapacitetet institucionale dhe teknike për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve për të gjithë qytetaret.

Qeveria e Kosovës dhe donatorët kanë siguruar një kontribut thelbësor për këtë proces dhe janë plotësisht të përkushtuar që këtë mbështetje ta vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme.

Raporti që keni në dorë, paraqet investimet publike komunale që ka bërë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2010.

Ne shpresojmë që këto investime, do të shtojnë kapacitetet komunale, përmes të cilave individët, organizatat dhe gjithë shoqëria përgjatë periudhës së ardhshme kohore mund të kenë, forcojnë dhe mirëmbajnë aftësitë e tyre për të përcaktuar dhe arritur objektivat e tyre zhvillimore, sepse qytetaret tanë kanë nevojë për shërbime më efikase.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përkrah të gjitha komunat, duke përfshirë edhe komunat e reja, me mjete buxhetore për të realizuar projekte të ndryshme të infrastrukturës publike dhe po ashtu Ministria është koordinatori kryesor për nivelin lokal për të orientuar ndihmën e jashtme në mënyrën e duhur dhe sipas prioritetëve.

Nga ky raport ju mund të vëreni se, duke punuar bashkë me komunat ne kemi shtuar sipërfaqet e parkingjeve dhe gjelbërimeve, kemi godina shkollore e shëndetësore të reja, kemi shtuar kilometrat e qypave të ujit e rrjetit të kanalizimeve, kemi ndërtuar godina për stafin e administratës komunale dhe tani bilanci është shumë më mirë se vetëm një vit më parë.

Prandaj, shpresojmë që duke vazhduar për të punuar bashkërisht, do të rrisim këto kapacitete, për të krijuar një ambient të sigurt dhe të prosperuar për qytetarët e Kosovës.

Sinqerisht,

Slobodan Petrović, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

1. Përmbledhja ekzekutive

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me misionin e saj në raport me komunat ka për qëllim Avancimin e Qeverisjes Lokale në Bashkëpunim me Institucionet tjera relevante, që konsiston në sigurimin e shërbimeve efikase në nivel komunal dhe sa më afër qytetarëve.

MAPL si çdo vit buxhetor edhe këtë vit ka përkrahur komunat me mjete kapitale për të realizuar projekte të ndryshme të infrastrukturës publike me qëllim të përmirësimit të kushteve të infrastrukturës për të gjithë qytetarët e Kosovës. MAPL tashmë është një prej koordinatorëve kyç për nivelin lokal për të orientuar edhe donacionet në nivelin e duhur dhe sipas prioriteteve.

Ky raport është i detajizuar dhe paraqet bashkëfinancimin e MAPL-së në shumë projekte të komunave, ka raste ku MAPL është financues i projektit në tërësi. MAPL në vitin 2010 gjithsej ka realizuar 99 projekte në 36 komunat e Republikës së Kosovës, këto projekte janë të paraqitura në pjesën e parë të raportit ku janë të ndara në 4 grupe sipas regjioneve koordinuese.

2. Koordinimi dhe Monitorimi i Projekteve

Ministria e Administrimi të Pushtetit Lokal monitorimin dhe ecurinë e projekteve nëpër komunat e Republikës së Kosovës e ka realizuar duke i ndarë zyrtarët e Departamentit të Zhvillimit Regjional dhe Integriteteve Evropiane në katër grupe punuese ku secili grup ka pasur në përgjegjësi monitorimin e projekteve. Katër grupet që kanë koordinuar dhe monitoruar projektet janë mbikëqyrur nga drejtori i DZHRIE-s z. Besim Kamberaj.

Grupi I ka qenë i përbërë prej: Fetije Begolli, Besa Shala, Hanife Alimusaj dhe Tush Berisha ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Fushë Kosovë, Zveçan, Suharekë, Malishevë, Deçan, Gjakovë, Istog, Pejë dhe Junik.

Grupi II ka qenë i përbërë prej: Emine Hoti dhe Sabajete Hoxha, ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Gllogoc, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Graçanicë, Prizren dhe Rahovec.

Grupi III ka qenë i përbërë prej: Ramadan Potera ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Mamushë, Shtërpc, Novo Berdë, Kaçanik, Kamenicë, Ferizaj, Viti, Hani Elezit, Partesh dhe Ranilluk.

Grupi IV ka qenë i përbërë prej: Mehdi Retkoceri dhe Fatmire Thaqi ky grup ka monitoruar projektet në këto komuna: Klinë, Dragash, Leposaviq, Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok, Gjilan, Klllokot dhe Mitrovica e Veriut.

3. Raporti detaj për secilin prej 99 projekteve sipas regjioneve koordinuese

Komuna	Fushë Kosovë	
Titulli i projektit	Ndërtimi i fushave për sporte të vogla	
Përshkrimi i Projektit	Rregullimi i 8 fushave të sporteve të vogla ku janë përfshirë rregullimi i rrethojave, hapësirave gjelbëruese dhe asfaltimi i fushave sportive e cila i ka përmirësuar kushtet rekreative – sportive në këtë komunë.	
Outputet / Përfitimet	Kanë përfituar 8 shkolla të fshatrave të Fushë Kosovës, nxënësit, të rinjtë dhe komuniteti i këtyre fshatrave duke zhvilluar aktivitete të ndryshme sportive dhe rekreacion.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	09.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	220,000.00 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	04.06.2010	
Vlera e Kontraktuar	211,840.52 €	
Emri i Kontraktuesit	"Tekno Ing Consulting" Sh.p.k Prishtinë	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	211,840.52 €	



Komuna	Fushë Kosovë	
Titulli i projektit	Ndërtimi i fushave të vogla sportive	
Përshkrimi i Projektit	Mbulimi me barin sintetik sipas planit, projektit dhe standardeve të përgjithshme në tri fshatrat: Bardh i Madh, Miradi e Epërme dhe Harilaq (faza e tretë).	
Outputet / Përfitimet	Me këtë projekt përfitojnë të rinjtë dhe komuniteti i këtyre fshatrave duke zhvilluar aktivitete të ndryshme sportive dhe rekreacion.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit		09.03.2010.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL		53,000.00 €
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga		Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës		25.11.2010
Vlera e Kontraktuar		38 515.56 €
Vlera e Aneks Kontratës		
Emri i Kontraktuesit		“Gjashtë vëllezërit BATATINA” Podujevë
Pagesat		
Vlerat e pagesës		38,515.56 €



Komuna	Fushë Kosovë	
Titulli i projektit	Ndërtimi i terenit sportiv ne oborrin e shkollës fillore “Mihail Grameno”	
Përshkrimi i Projektit	Rregullimi i terenit me rrafshim, asfaltim, mbulim me barin sintetik dhe rrethoj metalike.	
Outputet / Përfitimet	Nga ky projekt ka përfituar komuniteti (55000 banor) dhe 1500 nxënës të kësaj shkolle të cilët do të shfrytëzojnë për rekreacion dhe aktivitete të ndryshme sportive.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit		21.10.2010
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL		45,500.00€
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga		Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës		18.11.2010
Vlera e Kontraktuar		43,350.56 €
Emri i Kontraktuesit		“VALONI” Podujevë
Pagesat		
Vlerat e pagesës		43,350.56 €





Komuna	Suharekë	
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrugës "Brigada 123" Faza II	
Përshkrimi i Projektit	Është bërë zgjerimi i rrugës magjistrale në hyrje të Suharekës në anën e djathtë si dhe ndalja emergjente për raste të nevojshme ku do të bëhet eliminimi i rrezikut nga fatkeqësitë në komunikacion.	
Outputet / Përfitimet	Qytetarët dhe banorët e Komunës së Suharekës	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	04.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	182,000.00 €	
Totali i vlerës së zotuar nga Komuna	50,000.00 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	01.07.2010	
Vlera e Kontraktuar	184,433.01	
Vlera e Aneks Kontratës	15,699.96 €	
Emri i Kontraktuesit	"Gashi Ing" Suharekë	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	182,000.00 €	



Komuna	Malishevë	
Titulli i projektit	Kanalizimi ne fshatin Temeqin-Bubel	
Përshkrimi i Projektit	Kanalizimi është i gjatë 22 km, ndërsa faza e parë është 4 km, nga fshati Bubël gjerë në Temeqin, i cili është ndërtuar sipas standardeve të parapara me projekt. Ky kanalizim i përfshin rrjedhat e ujërave të zeza të 26 fshatrave me një kapacitet të tubave Fi-800.	
Outputet / Përfitimet	Me këtë projekt përfitojnë 26 fshatra më afër 50.000 banore, duke e eliminuar rrezikun nga ndonjë epidemi dhe sëmundje të ndryshme, parandalohet ndotja e lumit Mirusha dhe ndotja e ambientit dhe njëherit rritet mirëqenia e këtij komuniteti.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit		22.03.2010
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL		136,500.00 €
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga		Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës		07.04.2010
Vlera e Kontraktuar		456,007.83 €
Emri i Kontraktuesit		“JEHONA”
Pagesat		
Vlerat e pagesës		136,500.00 €



Komuna	Deçan	
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrugës Sali Qeku dhe Sheshi Mentor Tolaj	
Përshkrimi i Projektit	Asfaltimi i rrugës është bërë në gjerësi që të munden të kalojnë dy automjete në të njëjtën kohë në drejtime të ndryshme si dhe zgjerimi me trotuare dhe shiritin e gjelbërimit ku do të ketë edhe infrastrukturën përcjellëse si kanalizimin e ujërave të zeza dhe zebrat për kalimin e këmbësorëve i cili do të mundësoj qarkullimin e lirë dhe më të mirë të qytetarëve	
Outputet / Përfitimet	Kanë përfituar të gjithë banorët e Komunes së Deçan.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	23.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	/	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	158,580.00 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	05.07.2010	
Vlera e Kontraktuar	138,781.66 €	
Vlera e aneks kontratës	13,367.87 €	
Emri i Kontraktuesit	NNTPP"ENGINEERING GROUP"SH.P.K, Deçan	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	152,149.53 €	



Komuna	Deçan	
Titulli i projektit	Platoja hyrëse para objektit te komunës	
Përshkrimi i Projektit	Platoja është ndërtuar me asfalt dhe kubëza, një rampë për njerëzit me aftësi të kufizuar dhe hyrja .	
Outputet / Përfitimet	Me këtë projekt përfiton komuniteti me një qasje më të lehtë në komunë për realizimin e shërbimeve komunale .	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	23.03.2010.	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	23,419.76 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna	
Data e nënshkrimit të kontratës	21.07.2010	
Vlera e Kontraktuar	23,419.00 €	
Emri i Kontraktuesit	“ Kosova e Lire”	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	23,419.00 €	



Komuna	Deçan	
Titulli i projektit	Ndriçimi i rrugës “Sali Qeku”	
Përshkrimi i Projekti	Ndriçimi është bërë sipas projektit dhe standardeve për rrugët urbane.	
Outputet / Përfitimet	Me këtë projekt përfiton komuniteti, me një qarkullim më të lehtë dhe me një rritje të sigurisë në trafik.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	22.10.2010.	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	30,000.00 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna	
Data e nënshkrimit të kontratës	27.09.2010.	
Vlera e Kontraktuar	108,394.20 €	
Emri i Kontraktuesit	NNTPP “Enginjering Grup” - Deçan	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	29,899.40 €	



Komuna	Gjakovë	
Titulli i projektit	Ndërtimi i shkollës fillore "Isa Boletini" Osek Hylë në Gjakovë	
Përshkrimi i Projektit	Ndërtimi i shkollës – faza e parë. Shkolla ekzistuese nuk i ka plotësuar kushtet për zhvillimin e procesit arsimor, është ndërtuar objekti me 5 klasa mësimi, hapësirë për parashkollor si dhe hapësirat përcjellëse sipas standardeve. Në këtë shkollë do t’i vijojnë mësimet 197 nxënës dhe kuadri tjetër arsimor. Ky projekt ende nuk ka përfunduar dhe do të vazhdoj në vitin pasues.	
Outputet / Përfitimet	Banorët dhe nxënësit e fshatit Osek Hylë.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	02.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	182,000.00 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	28.09.2010	
Vlera e Kontraktuar	176,333.17 €	
Emri i Kontraktuesit	"Magg-Holding"Sh.p.k Prishtinë & N.N.SH."Korben" Gjakovë	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	149,883.19 €	



Komuna	Istog
Titulli i projektit	Ndërtimi i kanalizimit fekale në Banje- Lagja e Gecajve
Përshkrimi i Projektit	Ndërtimi i kanalizimit gjerë në derdhjen e tij në impiantin e Drinit të Bardhë në fshatin Baice, gjatësia 2.1 km, ky kanalizim do të ndërtohet në bazë të projektit dhe standardeve të përgjithshme për ndërtimin e kanalizimeve fekale.
Outputet / Përfitimet	Në këtë kanalizim kyçen mëse 300 familje me afër 2100 banorë multi-etnik. Përfitimet e komunitetit janë të shumëfishta si rritja e mirëqenies, standardit jetësor, eliminimit të përhapjes së epidemive dhe sëmundjeve të ndryshme si dhe pengimi i migrimit .
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	04.03.2010.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	91,000.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	29.06.2010
Vlera e Kontraktuar	101,754.60 €
Emri i Kontraktuesit	”Hidrodrini” -Klinë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	91,000.00 €



Komuna	Istog
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës në fshatin Kërrnin (faza e II)
Përshkrimi i Projektit	Trasimi në gjerësi dhe përgatitja e terrenit për asfaltim, si dhe asfaltimi në gjatësi prej 2.4 km dhe gjerësi prej 5 metra.
Outputet / Përfitimet	Kjo rrugë i lidhë fshatrat me magjistralen Pejë-Mitrovicë me ç’rast rritet mirëqenia jetësore e këtyre banorëve, ndërsa në mënyrë indirekte ndikon edhe në zhvillimin e degëve tjera ekonomike
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	04.03.2010.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	91,000.00 €
Totali i vlerës së zotuar nga Komuna	48,850.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	13.05.2010
Vlera e Kontraktuar	139,850.00 €
Vlera e Aneks Kontratës	
Emri i Kontraktuesit	“Conex-grup” SHPK-Prishtinë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	91,000.00€



Komuna	Istog
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës ne Istog të Poshtëm
Përshkrimi i Projektit	Trasimi në gjerësi dhe përgatitja e terrenit për asfaltim si dhe asfaltimi ne gjatësi prej 2 km dhe gjerësi prej 5 metra.
Outputet / Përfitimet	Kjo rrugë i lidh fshatrat me magjistralen Pejë-Istog me ç'rast rritet mirëqenia jetësore e këtyre banorëve ndërsa në mënyre indirekte ndikon edhe në zhvillimin e degëve tjera ekonomike.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	04.03.2010
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	91,000.00 €
Totali i vlerës së zotuar nga Komuna	68,671.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	21.09.2010.
Vlera e Kontraktuar	159,671.00 €
Vlera e Aneks Kontratës	
Emri i Kontraktuesit	SHPK "Shkambi" Istog
Pagesat	
Vlerat e pagesës	91,000.00 €



Komuna	Pejë
Titulli i projektit	Nivelizimi i qendrës së qytetit në Pejë
Përshkrimi i Projektit	Faza e dytë është vazhdimësi e ndërtimit të parkut të qytetit ku sipas projektit do të ketë gjelbërim, staza me katror, ujë-rrjedha të shiut, një lapidar dhe një fushë shahu.
Outputet / Përfitimet	Me këtë projekt përfiton komuniteti i këtij qyteti duke pasur një hapësirë për rekreacion të nevojshëm, pamje estetike për qytetin dhe infrastrukturë e turizëm .
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	27.08.2010
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	136,500.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	01.10.2010.
Vlera e Kontraktuar	245,292.60 €
Emri i Kontraktuesit	N.N.SH."VRAGA" -Peje
Pagesat	
Vlerat e pagesës	136,500.00 €



Komuna	Junik	
Titulli i projektit	Ndërtimi i Objektit të Administratës K.K.Junik	
Përshkrimi i Projektit	Ndërtimi i objektit të administratë – faza e dytë, ku përfshihen punimet finale, elektriku, suvatimi, ngrohja qendrore, dyshemetë, fasada e jashtme, ujësjellësi dhe punimi i brendshëm sanitar, dyert e dritaret (zdrukthëtaria), sistemi i alarmit kundër zjarrit, hidrantët dhe sistemi i teknologjisë informative etj.	
Outputet / Përfitimet	Kanë përfituar banorët e Junikut duke ju ofruar kushte më të mira për punë dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	20.05.2009	
Data e nënshkrimit te Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	464,044.80 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	05.07.2010	
Vlera e Kontraktuar	268,819.47 €	
Vlera e aneks kontratës	10,735.50 €	
Pagesë nga viti i kaluar-Faza e I	106,987.80 €	
Emri i Kontraktuesit	N.N.T“ Albes “ Istog	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	390,405.03 €	



Komuna	Junik
Titulli i projektit	Rregullimi i oborrit të ndërtesës së komunës
Përshkrimi i Projektit	Rregullimi i oborrit do të bëhet sipas projektit të paraparë duke përfshi rrafshimin, ndërtimin e hyrjes, stazave si dhe gjelbërimin me disa pushimore të vogla dhe drenazhim.
Outputet / Përfitimet	Rregullimi i oborrit mundëson që komuniteti të hyn dhe lëvizë më lehtë për kryerjen e shërbimeve komunale në objektin e administratës .
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	20.09.2010.
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	39,000.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	05.11.2010
Vlera e Kontraktuar	36,677.00 €
Emri i Kontraktuesit	“Kosova e Lire” Junik
Pagesat	
Vlerat e pagesës	36,677.00 €



Komuna	Glllogoc	
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik	
Përshkrimi i Projektit	Kjo rrugë është një segment që lidhë banorët e fshatit Terstenik të cilët kanë qasje në këtë rrugë. Gjatësia e kësaj rruge është rreth 3500m dhe me gjerësi të mjaftueshme. Asfaltimi i kësaj rruge ndikon në zhvillimin ekonomik, mirëqenie sociale si dhe zvogëlon lëvizjen e qytetarëve fshat-qytet që është bërë dukuri kohët e fundit në këtë fshat për shkak të mungesës së infrastrukturës së domosdoshme.	
Outputet / Përfitimet	Zvogëlimi i migrimit të banorëve të këtyre fshatrave. Zhvillimi më i madh ekonomik i këtyre fshatrave në aspektin kulturor dhe social.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit		01.03.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL		109,200.00 €
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga		Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës		14.05.2010
Vlera e Kontraktuar		210,951.20 €
Emri i Kontraktuesit		”Kalaja”Sh.P.K-Skenderaj
Pagesat		
Vlerat e pagesës		109,199.76 €




Komuna	Lipjan
Titulli i projektit	Ndërtimi i Kanalizimit Fekal në Fshatin Shalë-Faza e II
Përshkrimi i Projektit	Ujërat e zeza fekale në këtë fshat kanë rrjedhur në sipërfaqe të hapura të tokës. Rrjedha e këtyre ujërave fekale ka paraqitur rrezik për ndotjen e ambientit, ndotjen e ujërave nëntokësore që paraqet rrezik për dekontaminimin e ujit të pishëm në fshatin Shalë si dhe rrjetin e ujësjellësit i cili është i instaluar në këtë fshat. Rrjeti i kanalizimit është ndërtuar sipas normave dhe standardeve ndërtimore siç janë: Ndërtimi i gropës septike, montimi i gypave nga politeleni i brinzuar i cili rrjet do të lidhet me rrjetin kryesor të fshatrave tjera që vazhdon për në qytetin e Lipjanit
Outputet / Përfitimet	Fshati Shalë do të ketë një përfshirje në rrjetin e kanalizimit i cili ndikon në përmirësimin e jetës së qytetarit.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	30.09.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	91,000.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	20.10.2010
Vlera e Kontraktuar	198,441.14 €
Emri i Kontraktuesit	“Linda” sh.p.k
Pagesat	
Vlerat e pagesës	91,000.00.€



Komuna	Obiliq
Titulli i projektit	Ndërtimi i rrugës Lajthisht - Hamidi
Përshkrimi i Projektit	Gjatësia e kësaj rruge është L=2300m, rruga lidh fshatin Lajthisht dhe Hamidi, fshatra këto me konfiguracionin e terrenit të ndryshme ku këto fshatra lidhem me rrugën kryesore të asfaltuar e cila është arterie që lidh fshatrat e kësaj pjese me qendrën (Obiliqin) si dhe qendrat tjera. Realizimi i këtij projekti ndikon në përmirësimin e kushteve të transportit për automjete dhe qarkullimin e qytetarëve dhe në zhvillimin e bizneseve.
Outputet / Përfitimet	Udhëtimi i shpejt dhe i sigurt, zgjidhja e problemit të udhëtimit për banorët e këtyre fshatrave dhe kompletimi i infrastrukturës rrugore.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	24.03.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	63,700.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	06.07.2010
Vlera e Kontraktuar	163,027.99 €
Emri i Kontraktuesit	“Alfa”Sh.P.K
Pagesat	
Vlerat e pagesës	63,700.00 €



Komuna	Obiliq	
Titulli i projektit	Kanalizimi në fshatin Dardhishtë-Obiliq	
Përshkrimi i Projektit	Kanalizimi i fshatit Dardhishtë dhe i lagjes Mazgit është i gjatë 3300 m, është punuar me gypa PVC si dhe puseta nga betoni, ky projekt ka bërë rregullimin e infrastrukturës nëntokësore të kësaj pjese të banuar dhe ka përmirësuar higjienën e ekonomive familjare dhe institucioneve sociale.	
Outputet / Përfitimet	Banorët e fshatit Dardhishtë dhe të lagjes Mazgit.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	22.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	66,100.00 €	
Totali i vlerës së zotuar nga Komuna		
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	16.08.2010	
Vlera e Kontraktuar	66,048.84 €	
Vlera e Aneks Kontratës		
Emri i Kontraktuesit	" DKG" Sh.A-Prishtinë	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	66,048.84 €	



Komuna	Obiliq	
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës në fshatin Plemetin-Lagja e Bregajve	
Përshkrimi i Projektit	Është bërë asfaltimi i rrugës me gjatësi 1175m, gjerësi 6m, një pjesë me rigolla dhe pjesa tjetër me bankina, kanalet e hapura për ujera atmosferik. Kjo rrugë ju mundëson banorëve kushte më të mira për jetë.	
Outputet / Përfitimet	Banorët e fshatit Plemetin – lagja e Bregajve.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	22.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	109,200.00 €	
Totali i vlerës së zotuar nga Komuna		
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	MAPL	
Data e nënshkrimit të kontratës	19.08.2010	
Vlera e Kontraktuar	100,196.66 €	
Vlera e Aneks Kontratës	8,390.86 €	
Emri i Kontraktuesit	" DKG" Sh.A-Prishtinë	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	108,587.52 €	



Komuna	Podujevë
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës Letancë – Bajqinë
Përshkrimi i Projektit	Nëpër këtë rrugë frekuentojnë banorët e fshatit Bajqinë, Letanc, Doberdol, Zakut numri i të cilave është më tepër se 6.000 banor. Në këtë rrugë qarkullojnë edhe shumë banorë të fshatrave tjera që gjenden rreth fshatrave të cekura më lartë pasi që kjo rrugë e shkurton rrugën për në Podujevë. Këtë rrugë e frekuentojnë 1.600 banor të fshatit Bajqinë, 1.600 banor të fshatit Doberdol, 700 banor të fshatit Zakut, 1.700 banor të fshatit Letanc dhe shumë banor të fshatrave për rreth. Me realizimin e këtij projekti banorëve të kësaj ane ju lehtësohet udhëtimi deri në Podujevë.
Outputet / Përfitimet	Është bërë zgjerimi i rrugës dhe qarkullimi i qytetareve dhe nxënësve është shume me i lirshëm.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	04.03.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	123,000.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	17.09.2009
Vlera e Kontraktuar	397,873.46 €
Emri i Kontraktuesit	„Toifor” shpk, Prishtinë
Pagesat	
Vlerat e pagesës	123,000.00 €





Komuna	Podujevë
Titulli i projektit	Rregullimi i lumit Llap
Përshkrimi i Projektit	Gjendja në shtratin e lumit Llap ka qenë e vështirë në sezonet kur të reshurat janë më të mëdha, kryesisht në sezonin e pranverës dhe sezonin vjeshtë-dimër. Në këto sezone lumi del nga shtrati dhe vërshon shtëpi dhe toka të punueshme dhe shkakton dëme të mëdha. Me këtë projekt është bërë pastrimi dhe zgjerimi i lumit në ato pjesë ku janë shkaktuar probleme nga vërshimet.
Outputet / Përfitimet	Do të këtë një ambient më të pastër dhe nuk do të këtë më vërshime. Si dhe do të ketë një ambient më të bukur për qytetaret e kësaj ane.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	01.03.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	63,700.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	23.08.2010
Vlera e Kontraktuar	116,309.26 €
Emri i Kontraktuesit	“Bini” Sh.P.K
Pagesat	
Vlerat e pagesës	63,700.00 €



Komuna	Podujevë
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës “Dëshmorët” me kanalizim fekal
Përshkrimi i Projektit	Gjatësia e rrugës është L=2.00 km, kurse gjerësia është B=5.5 metra. Kjo rrugë është e pa asfaltuar dhe e vështirë për qarkullim. Numri i banorëve që shfrytëzojnë këtë rrugë është rreth 500 banor. Rruga është ndërtuar me standarde të larta evropiane dhe qytetarët do të kenë qasje më të mirë në rrugë.
Outputet / Përfitimet	Do të krijohen mundësi të reja të shërbimeve në infrastrukturën rrugore.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	01.03.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	260,787.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	21.10.2010
Vlera e Kontraktuar	235,935.55 €
Emri i Kontraktuesit	“Toifor” Sh.P.K
Pagesat	
Vlerat e pagesës	235,935.55 €



Komuna	Prishtinë
Titulli i projektit	Renovimi i sallës së Kuvendit
Përshkrimi i Projektit	Salla e Kuvendit Komunal ka qenë në gjendje jo të mirë dhe si e tillë nuk ka qenë në gjendje ti plotësoj kushtet për funksionim. Në këtë sallë është punuar në punët demoluese, dyshemetë, muret, dyer dhe dritare, suvatimi dhe patinimi, plafonët, dekorimi si dhe inventarizimi.
Outputet / Përfitimet	Renovimi i sallës dhe krijimi i kushteve më të mira për këshilltarët komunal, zyrtarët vendor dhe ndërkombëtar dhe ofrimin e një ambient më të mirë për debate me qytetar, kjo sallë është pas rregullimit është më funksionale.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	25.03.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	227,500.00 €
Kontratat	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës I	30.09.2010
Vlera e Kontraktuar I	82,233.35 €
Emri i Kontraktuesit	N.N.T."Union -Enterier"
Data e nënshkrimit të kontratës II	19.11.2010
Vlera e Kontraktuar II	28,171.44 €
Emri i Kontraktuesit II	N.N.P."Xhenti
Data e nënshkrimit të kontratës III	22.10.2010
Vlera e Kontraktuar III	49,880.77 €
Emri i Kontraktuesit	N.N.P.T"Lesna Ing Af"Sh.P.K
Pagesat e përfunduara	
Pagesa e parë	41,091.08 €
Pagesa e dytë	41,117.00 €
Pagesa e tretë	20,000.00 €
Pagesa e katërt	42,398.66 €
Vlera e pagesave	144,606.74 €



Komuna	Graçanicë	
Titulli i projektit	Rregullimi i shtratit të lumit Graçanicë	
Përshkrimi i Projektit	Në këtë projekt është kryer sanimi dhe rekonstruimi i shtratit të lumit Graçanica në gjatësi prej L=400.0m. Gjerësia mesatare e shtratit është 5.50 m, me gjerësinë e tërë shtratit në kurorë prej 11,0m. Në pjesën qendrore afër urës është bërë zgjerimi i shtratit D-16m me fontanën në brendësi të shtratit të lumit në tri nivele me ndriçim. Muri i bregut të lumit është punuar nga guri me llaq të çimentos dhe me llaq në maje. Në anën e majtë përgjatë rrjedhës së ujit është ndërtuar staza për këmbësor afër shtratit të lumit nga gurët e thyer në bazën e përgatitur. Staza e këmbësoreve është e furnizuar me ulëse për pushim dhe me llampiona.	
Outputet / Përfitimet	Qytetarët do të kenë një mjedis më të pastër, vendi do të ketë një pamje më të bukur dhe do të zvogëlohet rreziku nga vërshimet.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit		01.04.2010
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		25.06.2010
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL		160,000.00 €
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga		Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës		21.05.2010
Vlera e Kontraktuar		159,909.32 €
Emri i Kontraktuesit		Conex Group
Pagesat		
Vlerat e pagesës		158,409.32 €



Komuna	Graçanicë	
Titulli i projektit	Ndërtimi i fushës së tenisit në Graçanicë	
Përshkrimi i Projektit	Janë ndërtuar dy fusha të tenisit me tribunë për shikuesit. Sipërfaqja e fushës është 42x38m. Për shkak të denivelizimit të madh të terenit është ndërtua muri mbrojtës i lartë 3m. Tribunat janë kryer me tri palë shkallë të krahut hyrës. Rrethoja është bërë me profil katror të çelikut.	
Outputet / Përfitimet	Ka përfituar rinia për zhvillimin e aktiviteteve sportive.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	01.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	33,202.10 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna	
Data e nënshkrimit të kontratës	27.04. 2010	
Vlera e Kontraktuar	99,928.68 €	
Emri i Kontraktuesit	CO ING	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	33,202.10 €	



Komuna	Graçanicë	
Titulli i projektit	Rregullimi dhe ndriçimi i trotuareve Dobrotinë-Gustericë	
Përshkrimi i Projektit	Ndërtimin e stazës për këmbësor me gjerësi mesatare nga b=1,50m. Në anën nga rruga e asfaltuar është bërë cepi standard i masës së betonit MB 20 dhe fundori me mase betoni MB 20. Vet staza e këmbësoreve është ndërtua nga pllaka e betonit të trashësisë d=7 cm. Përgjatë trasesë është shtri kabllloja për lidhjen e shtyllave për drita në rrjetin elektrik,me tokëzimin adekuat. Në 10 vende gjatë stazës së këmbësorëve janë vendosur ulëset.	
Outputet / Përfitimet	Përfitimi i qytetareve me ndriçim të rrugëve natën.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	01.03.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	29,433.95 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna	
Data e nënshkrimit të kontratës	27.04.2010	
Vlera e Kontraktuar	98,795.60 €	
Emri i Kontraktuesit	E B NN	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	29,433.95 €	



Komuna	Graçanicë
Titulli i projektit	Rregullimi i ndriçimit prej Graçanicës deri në Llapnasellë
Përshkrimi i Projektit	Në kuadër të këtij projekti është kryer ndriçimi gjatë rrugës Garaçanicë -Lapje Sello në gjatësi prej 4000m. Janë vendosë 80 shtylla dhe ndriçim metal-halogjen 250w. Largësia në mes të fushave të shtyllave është 50m, i tërë instalimi është bërë nga kabllot elektrike, me prerje sipas standardeve për këtë lloj pune me tokëzim adekuat.
Outputet / Përfitimet	Staza për këmbësorë me ndriçim do të ju mundësojë qytetarëve lëvizje më të lirshme dhe siguri në orët e mbrëmjes.
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit	
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	01.03.2010
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	
Totali i vlerës së zotuar nga MAPL	19,797.00 €
Kontrata	
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna
Data e nënshkrimit të kontratës	11.05.2010
Vlera e Kontraktuar	79,001.36 €
Emri i Kontraktuesit	Conex Group
Pagesat	
Vlerat e pagesës	19,797.00 €



Komuna	Graçanicë	
Titulli i projektit	Rregullimi i fushës së futbollit në Dobratin	
Përshkrimi i Projektit	Fusha e sportit është bërë me dimensione prej 55/25m me sipërfaqe të asfaltit , tribunave , rrethojës me lartësi 4m, portat e futbollit të vogël, hendbollit dhe koshave të basketbollit. Rrethoja është ndërruar komplet. Është bërë punimi i ndriçimit adekuat për shfrytëzim gjatë natës.	
Outputet / Përfitimet	Aktivitetet sportive do të mundësojnë socializmin e të rinjëve, që si rezultat do të kemi një gjenerate të shëndoshë.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	14.04.2010	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit		
Totali i vlerës se zotuar nga MAPL	4,922.00 €	
Kontrata		
Procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga	Komuna	
Data e nënshkrimit të kontratës	16.06.2010	
Vlera e Kontraktuar	9,833.00 €	
Emri i Kontraktuesit	NIN-Graçanicë	
Pagesat		
Vlerat e pagesës	4,916.50 €	



Komuna	Graçanicë	
Titulli i projektit	Asfaltimi i rrugës Graçanicë-Llapnasellë	
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt ka përfshi asfaltimin e rrugës në gjatësi prej 3km dhe gjerësi prej 6m. Rrugës i është punuar trotuari në njërën anë.	
Outputet / Përfitimet	Banorët e kësaj pjese do të qarkullojnë më lehtë dhe sigurt, gjithashtu qarkullimi do të lehtësohet edhe për ngasësit e automjeteve.	
Përgatitja dhe Faza e Aprovimit		
Data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit	05.06.2009	
Data e nënshkrimit të Aneks Marrëveshjes së Mirëkuptimit	03.11.2009	
